



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0384

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi- Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Besim A. Zejnullahu B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi I institucioneve edukative arsimore me numër të prokurimit 616-23-1565-2-2-1, me 03/08/2023, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Besim A.Zejnullahu B.I” , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 12.06.2023 (me numër protokolli 384/23), vendimi për aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore “ me nr. të prokurimit: "616-23-1565-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes se Prishtines, mbetet në fuqi.

2. Konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP, konfiskohen mjetet e depozituara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 06.03.2023, Komuna e Prishtines, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me nr. të prokurimit: "616-23-1565-2-2-1". Nderkaq me datën 02.06.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “Besim A.Zejnullahu B.I” me datën 26.05.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 02.06.2023, AK- Komuna e Prishtines me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Besim A.Zejnullahu B.I “lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi,

dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me numër të prokurimit “616-23-1565-2-2-1” të inicuar nga Komuna e Prishtines.

AK ne vendim ka kërkuar të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin për dhënie të AK –Komuna e Prishtines lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me numër të prokurimit “616-23-1565-2-2-1”.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Besim A.Zejnullahu B.I” me datën 12.06.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 384/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 30.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 22.06.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Besim A.Zejnullahu B.I”.

Të aprovohet si e bazuar, si dhe **të anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Sqarim hyrës: Sipas ankesës 384/23 janë përshkruar gjithsej 4 pretendime ankimore, megjithatë vlerësojmë se këto pretendime mund të përmblihen në dy apo edhe një pretendim kryesor ankimore-konkretisht mos plotësimi i kërkesës së OE të rekomanduar për ofrimin e dëshmisë/certifikatës së analizave për disa produkte/preparate të ofruara nga OE.

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 384/23 është se OE i rekomanduar për kontratë, përmes dokumenteve të paraqitura:

“OE i propozuar për kontratë ka ofruar një deklaratë që sipas të cilës OE me rastin e realizimit të kësaj kontrate, ofrimin të shërbimeve do ta bëjnë në përputhshmëri me Specifikimet teknike sipas Aneksit nr.1, por me dokumentet të cilat i ka ofruar dhe dokumentet tjera të bashkangjitura me ofertë biejnë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe me këtë OE MONUNI ka vetë deklaruar se nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Specifikimet teknike në Aneksin 1.”

Pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk kemi gjetur asnjë lloj “vet deklarimi” të OE rekomanduar për kontratë se nuk plotëson kriteret.

Mendimi ekspertit shqyrtues është se OE ankues këtë pretendim e bazon te mos ofrimi i certifikatave të analizës (të kërkuara në dosje të tenderit tek aneksi 1-specifikat teknike).

Megjithatë vlerësimi ekspertit është se nuk mund të themi se është “vet deklarim” i OE të rekomanduar se nuk i plotëson kriteret.

Pretendimi nr.2

Pretendimi i dytë dhe kryesor sipas ankesës 384/23 është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar certifikata të analizës për pikën b (pllakat ngjithëse për minjë) dhe për produktin në pikën c) repelent për zvarranik.

OE i rekomanduar për pikën b dhe pikën c ka ofruar deklaratë të konformitetit,

Kërkesa decidive në dosje të tenderit aneksi 1 tek “Deratizimi” është si në vijim:

*“O.E për preparatet e kërkuara më lartë si në pikat a, b dhe c duhen të dëshmojë kopjet e **Certifikatave të Analizave**”.*

Vlerësimi jonë është se deklarata e konformitetit nga prodhuesi apo broshura nuk është në pajtim të kërkesës së dosjes për “certifikatë të analizave”, pasi certifikatat e analizave përmbajnë të dhëna shtesë rreth produktit, siç janë mënyra e testimit dhe rezultatet e testimit, rrezikshmëria etj, ndërsa deklarata e konformitetit zakonisht nuk përmban informata të tilla.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar dhe rekomandojmë që lënda të kthehet në rivlerësim.

Megjithatë duhet të shtojmë se në rastin konkret certifikata e analizës nuk është kërkesë e kualifikimit (FDT), por është kërkesë ekzekutive (Specifikim teknik) dhe pas hulumtimeve të bëra kemi gjetur se të njëjtat mund të lëshohen nga prodhuesi për çdo porosi/dërgesë të veçantë.

Sidoqoftë e njëjta (certifikata analizës) është kërkuar “të dëshmohet” përmes specifikimit teknik. Meqenëse certifikatat e analizës e kanë datën e fiksuar se kur janë lëshuar, rekomandojmë që AK me rastin (eventual) të rivlerësimin të kërkojë sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, nëse i njëjti arrin të dëshmojë certifikatat e analizës me datë të fiksuar para afatit të fundit për dorëzim të tenderit, në pajtim me nenin 72 par.3 të LPP-së.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të

konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli nuk i mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili i ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij, ngase mjaftë mirë e evidenton dhe e thekson, citat "Megjithatë duhet të shtojmë se në rastin konkret certifikata e analizës nuk është kërkesë e kualifikimit (FDT), por është kërkesë ekzekutive (Specifikim teknik) dhe pas hulumtimeve të bëra kemi gjetur se të njëjtat mund të lëshohen nga prodhuesi për çdo porosi/dërgesë të veçantë". Andaj, Paneli Shqyrtues nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim sepse fillimisht eksperti nuk ka ofruar asnjë argument ligjor lidhur me këtë rekomandim i cili bie ndesh me konstatime të bëra në ekspertizë të cilin sapo e cituam, kështu që PSH konstaton se pretendimi kryesor dhe përcaktues i vendimarrjes së këtij vendimi është sa i përket certifikatës së analizës e cila është kërkesë e specifikimit teknik dhe se kjo kërkesë nuk është kërkesë e kualifikimit dhe e përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë por është kërkesë e cila duhet të plotësohet gjatë ekzekutimit të kontratës dhe sipas nenit 56, paragrafit 3 të LPP, citon: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP, meqë e ka hartuar dosjen e tenderit në pajtim me kërkesat e domosdoshme, të parashikuara shprehimisht me dispozitën e nenit 27 (Dosja e Tenderit) lidhur me nenin 28 (Specifikimet teknike) të Ligjit të cituar kurse kriteret e aplikuar dhe veprimet e ndërmarra nuk karakterizohen me natyrë diskriminuese. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet

dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Besim A. Zejnullahu B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: